

# **Vendim Nr.1 datë 9.01.2020**

PËR EMËRIMIN GJYQTARE TË ZNJ. ERLANDA AGAJ

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 136/a dhe 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 35 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin nr. 229, datë 24.10.2019, “Për kualifikimin e kandidatës znj. Erlanda Agaj dhe vijimin e procedurës së emërimit si gjyqtare”, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

## **V E N D O S I :**

Të emërojë gjyqtare znj. Erlanda Agaj.

Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**